



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 48/1 prot.

Tiranë, më 26. 03. 2025

V E N D I M

Nr. 64, datë 26. 03. 2025

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹ shqyrtoi ankesën nr. 185 Regj., datë 10.09.2024, e E. B., kundër Departamentit të Administratës Publike (DAP), me pretendimin për diskriminim për shkak të gjendjes shoqërore² dhe çdo shkak tjetër³.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në parashtrimet e depozituara nga subjekti ankues, E. B., parashtron në ankesë se: “...kam punuar në një institucion që është në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme e Burgjeve, si IEVP Fier, IEVP Peqin, IEVP Rrogozhinë, dhe çdo vit ne firmosnim formularin e depolitizimit dhe pavarësisht eksperiencës time në këto institucione unë nuk e kisha statusin e nëpunësit civil, por isha me kontratë pune të përhershme.

Duke qenë se pata probleme shëndetësore në vitin 2022 duke ndikuar edhe largësia punë-shtëpi dhashë dorëheqjen në janar të 2022 si Përgjegjëse e Sektorit Financës pranë IEVP Rrogozhinë dhe që nga ajo periudhë kam punuar part-time si ekonomiste pranë një subjekti privat derisa të rimerrja veten.

Problemi që kam konsiston me aplikimin që kam bërë në DAP duke e menduar si një institucion të pavarur dhe të paanshëm për përzgjedhjen e kandidatëve fitues për punësim në Administratën Civile por në të vërtetë më doli e kundërta.

Kam aplikuar në qershor të 2024 për shpalljen nr. 6230, Lloji i diplomës “Arsim i lartë”, niveli minimal i diplomës “Bachelor”, për pozicionin e punës si Specialist në Sektorin e Administrimit të të

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

² Me gjendjen shoqërore ankuesja referon faktin që nuk ka bindje dhe nuk është e angazhuar në subjekte politike.

³ Nuk ka referuar asnjë cilësi lidhur me pretendimin për çdo shkak tjetër.

Dhënave dhe Përpunimit të Informacionit Fier, në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë – klasa e pagës IV-3 ku të gjitha të dhënat, dokumentacioni, kriteret etj., janë në portalin e shpalljes (bashkëlidhur materiali i printuar dhe dokumentacioni që kam në portalin e DAP).

Duke menduar se jam një kandidatë mjaft e përshtatshme për këtë pozicion me 13 vite eksperiencë pune, ku 6 i kam në sektorin privat dhe 7 në sektorin publik si Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Specialiste gjithashtu, aplikova në portalin e DAP ku ndoqa të gjitha procedurat derisa dola si kandidatë fituese me 71.4 pikë në rezultatet paraprake për këtë pozicion.

Organizimi i procedurave në pamje të parë dukej transparent por fatkeqësisht vërtetova të kundërtën, që nga testimi me shkrim ku na vendoseshin barkode për të identifikuar individin, ku barkodi ishte kodi i kartës së identitetit, një proces ky mediokër pasi individit ishte lehtësisht i identifikuar dhe rezultatet e testimit me shkrim mund të përpunohen shumë lehtë.

Intervista me gojë u zhvillua në kundërshtim me pikën nr. 9, udhëzimi nr. 02, datë 27.03.2015, ku thuhet se: llojet e pyetjeve për intervistën me gojë duhet të zhvillohen rreth:

1. Pyetje lidhur me sjelljen = asnjë pyetje;
2. Pyetje lidhur me situatën (hipotetike) = asnjë pyetje;
3. Pyetje lidhur me dijet = 5 pyetje me një metodikë pyetësori sikur të ishte në gjimnaz dhe mësuesja kërkonte mësimin përmendësh.

Dhe së fundmi pikët që jepen nga CV që përsëri nuk u vlerësua siç duhej.

Me datë 23.08.2024 jam paraqitur në zyrat e DAP si kandidatë fituese publikuar në rezultatet paraprake së bashku me kandidatët e tjerë dhe u njoha me renditjen e pikëve:

1. A. Xh. 76 pikë;
2. E. R. 72 pikë;
3. E. B. 71.4 pikë;
4. P. V. 86 pikë.

Sinqerisht më bën përshtypje pikët e larta që P. V. dhe bëra kërkim në internet dhe gjeta këto fakte mediatike:

1. Lista e Zezë, Rama publikon emra gjyqtarësh e prokurorësh (<https://gazeta-shqip.com/kryesoret/abuzimet-rama-publikon-emra-gjyqtaresh-e-prokuroresh/>);
2. Turpi i radhës i kësaj qeverie. Braçe bën drejtor një nga pinjollët e “Listës së zezë” të Ramës (<https://www.standard.al/2019/01/25/turpi-i-radhes-i-kesaj-qeverie-brace-ben-drejtorë-nje-nga-pinollet-e-listes-se-zeze-te-rames/>);
3. Përdorën spitalin e Lushnjës dhe administratën për fushatë zgjedhore, KAS gjobit kryebashkiaken e Lushnjës dhe Sekretaren e Ministrisë së Shëndetësisë, + P. V. (<https://top-channel.tv/video/fiks-fare-drejtori-i-spitalit-lushnje-pezellon-nga-puna-laboranten>), publikuar më 01.07.2021.”;
4. Zgjedhjet e 6 marsit, KQZ shpalli vendimet për 4 denoncime + P. V. (<https://ata.gov.al/2022/05/19/zgjedhjet-e-6-marsit-kqz-shpalli-vendimet-per-4-denoncime/>);
5. Fiks Fare/ Drejtori i spitalit Lushnje pezullon nga puna laboranten + P. V. (<https://top-channel.tv/video/fiks-fare-drejtori-i-spitalit-lushnje-pezellon-nga-puna-laboranten>);

6. Info nga postimet zyrtare FB P. V. – Kryetar i PS të Këshillit Socialist të Njësisë Administrative Krutje, foto publikuar më 24.01.2024.

Bazuar në këto fakte mendoj dhe besoj se KPP ka favorizuar kandidatin në fjalë për shkak të statusit të tij shoqëror dhe anëtarësimin politik, duke qenë se ka një historik profesional mbresëlënës si një ushtar i devotshëm i Partisë Socialiste dhe referenca e tij për punësim mund të ketë ardhur nga një deputet që ka ndikim të lartë politik.

Për këtë arsye kam bërë një ankesë kundër KPP në DAP me dt. 26.08.2024, për rishikimin e çështjes dhe shqyrtimin e saj nga një komision i paanshëm, por se sa do realizohet unë nuk e di.

Dihet që procedurat zgjasin dhe kjo çështje mund edhe të anashkalohet me një shkresë formale që kandidati fitues e ka dokumentacionin në rregull për tu shpallur fitues, për këtë arsye kërkoj ndihmën tuaj duke qenë se unë nuk kam tagër dhe as njohuri për interpretime ligjore por vetëm ekonomike, të hetoni rastin në fjalë nëse vërtetë DAP do bazohet në meritokraci në rishqyrtimin e çështjes apo jo dhe statusit shoqëror edhe pse diploma që ka kandidati fitues është për Farmaci dhe çfarë interesi ka ky kandidat të aplikojë për një pozicion specialist, ku ka qenë në pozicione pune drejtues.

A është ky një rast i mirëfilltë i shkëljes së ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen të emërohen ose të ushtrojnë funksione publike”, neni 3, pika e, ku përderisa Kryeministria ka dalë me një listë emrash për zyrtarë të korruptuar, normalisht bazohet në fakte dhe prova, se nuk mund të bëjë deklarata të hamendësuar apo jo dhe sa është kohëzgjatja për mospranim në shërbimin civil në varësi të shkëljes së kryer?

Në të tilla raste me çfarë motivacioni bëhet lirimi i këtyre zyrtarëve, dhe sa merret parasysh në ditët e sotme punësimi i një personi me njollë në biografi, se në kohën e komunizmit duhet të kalonin 3 breza dhe përsëri ta bënë me gisht, si fshihen këto njollat në realitetin tonë Shqiptar?...”.

Sakaq, E. B. ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që në përfundim të shqyrtimit të ankesës, të konstatojë diskriminim e saj nga ana e DAP për shkak të gjendjes shoqërore dhe çdo shkak tjetër, si dhe rivlerësimin e dosjes.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar (në vijim LMD), parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë,

që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën Nr. 1241/1 prot., datë 18.09.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga DAP, lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:

- Informacion dhe argumente lidhur me pretendimet e ngritura nga ana e E. B.
- Kopje të procedurës së konkurrimit për shpalljen e vendeve të punës nr. 6230.
- Procesverbalet e mbajtura të konkurrimit/vlerësimit të kandidatëve gjatë testimit me shkrim dhe intervistës me gojë, për shpalljen e vendeve të punës nr. 6230.
- Kopje të korrespondencës së mbajtur mes ankueses dhe DAP lidhur me procedurën e ndjekur për trajtimin e ankesës së saj, sa i përket procedurave të konkurrimit për shpalljen nr. 6230.
- Cilët ishin kandidatët e emëruar në pozicionet e lira të punës për shpalljen nr. 6230?
- Informacion dhe kopje të korrespondencës, nëse kishte patur ankesa të tjera nga kandidatët/konkurrentët e tjerë në këtë procedurë konkurrimi.

Në përgjigje sa më sipërcituar, përmes shkresës⁴ nr. 4495/3 prot., datë 04.10.2024, DAP vuri në dispozicion informacionin e kërkuar, duke sqaruar ndër të tjera se: “...Nga të dhënat e administruara nga DAP rezulton e E. B. ka marrë pjesë në procedurën e konkurrimit për pranimin në shërbimin civil, për pozicionet vakante me kod shpallje: #6230-Lloji i diplomës “Arsim i Lartë”, niveli minimal i diplomës “Bachelor”.

Referuar ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive (Specialist) bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur. Konkurrimi organizohet në mënyrë periodike nga njësia përgjegjëse (DAP) dhe zhvillohet në dy faza:

⁴ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1241/2 prot., datë 07.10.2024.

- a) Verifikimi paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkurrimit;
- b) Vlerësimi i kandidatëve.

Verifikimi paraprak i dosjeve të aplikantëve kryhet nga njësia përgjegjëse (DAP), ndërsa vlerësimi me pikë i kandidatëve bëhet nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP). KPP vlerëson kandidatët, realizon testimin e tyre me shkrim dhe me gojë dhe në përfundim të konkursit dorëzon pranë DAP listën e kandidatëve të renditur duke filluar nga kandidati që ka marrë më shumë pikë. Në vijim, bazuar në VKM nr. 243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, pika 17, Kreu IV, i ndryshuar, njësia përgjegjëse (DAP) fton kandidatët fitues, duke respektuar renditjen e tyre, të zgjedhin nga lista e pozicioneve ekzistuese të lira, për të konkurruar. Kandidatët fitues të cilët nuk mund të përzgjedhin pozicion për shkak të renditjes së tyre me fituesit e tjerë, qëndrojnë në listë fituese për një periudhë 2 vjeçare.

Lidhur me rastin konkret, përsa i përket shpalljes me kod 6230, në përfundim të afateve të aplikimit, në zbatim të pikës 2, të Kreut IV, të VKM-së nr. 243, datë 18.03.2015, njësia përgjegjëse DAP ka vijuar me verifikimin paraprak dhe përfundimtar, nëse kandidatët plotësojnë kushtet dhe kriteret e posaçme për vendet e lira. Nga verifikimi i dosjeve elektronike, referuar dokumentacionit të ngarkuar, ka rezultuar se E. B. plotëson kushtet minimale dhe kriteret e përcaktuara në shpallje dhe është kualifikuar për të vijuar me fazën e dytë të konkurrimit, sikurse janë kualifikuar edhe kandidatët e tjerë të cilët plotësojnë këto kritere. Lista paraprake dhe përfundimtare e kandidatëve të kualifikuar për të vijuar konkurrimin është publikuar në faqen tonë zyrtare (www.dap.gov.al).

Në vijim është zhvilluar procedura e konkurrimit për këtë grup pozicionesh dhe në përfundim të gjitha fazave të konkurrimit, KPP përcjell pranë DAP listën e kandidatëve të renditur duke filluar nga kandidati që ka marrë më shumë pikë. Referuar kësaj liste, DAP në cilësinë e njësisë përgjegjëse, ka vijuar me njoftimin individual të kandidatëve për rezultatet e marra në këtë konkurs dhe me publikimin në faqen zyrtare (www.dap.gov.al) të listës së kandidatëve fitues (me mbi 70 pikë), renditur sipas alfabetit. Në këtë njoftim kandidatët sqarohen edhe mbi të drejtën e ankimit, afatet, si edhe procedurën ligjore që duhet të ndjekin për të paraqitur ankesën pranë Departamentit të Administratës Publike.

Sa më sipër, nga verifikimet e kryera rezultoi se E. B. ka depozituar në rrugë zyrtare, brenda afatit ligjor të parashikuar, ankesën e saj për vlerësimin e marrë në konkursin me kod 6230. Në përgjigje të kësaj ankese, Komiteti i Përhershëm i Pranimit, i ngritur për zhvillimin e konkursit për pranimin në nivelin ekzekutiv për grupin e pozicioneve: #6230- Lloji i diplomës “Arsim i Lartë”, niveli i diplomës “Bachelor”, u mblodh në datën 22.08.2024 për të shqyrtuar ankesën e kandidatit. Në përfundim të shqyrtimit KPP ka kthyer përgjigje nëpërmjet shkresës përcjellëse të DAP me datë 23.08.2024, për të cilin E. B. është vënë në dijeni.

Në vijim, pas përfundimit të fazës së ankimit për rezultatet e këtij konkursi, DAP ka ftuar kandidatët fitues, duke respektuar renditjen e tyre, të zgjedhin nga lista e pozicioneve ekzistuese të

lira për të cilat kanë konkurruar. Renditja e kandidatëve fitues për këtë procedurë është si më poshtë:

1. P. V. 87.6 pikë
2. A. Xh. 76 pikë
3. E. R. 72.2 pikë
4. E. B. 71.4 pikë

Bazuar në këtë renditje, kandidatët kanë plotësuar deklaratat e fituesit duke përzgjedhur pozicionet si vijon:

- *Kandidati i renditur i pari me pikë, P. V. ka përzgjedhur pozicionin Specialist në Sektorin e Administrimit të të Dhënave dhe Përpunimit të Informacionit Fier, në Agjencinë Rajonale të Mjedisit, Fier/Vlorë/Gjirokastër- klasa e pagës IV-3.*
- *Kandidati i renditur i dyti me pikë, A. Xh. ka përzgjedhur pozicionin Specialist në Sektorin e Administrimit të të Dhënave dhe Përpunimit të Informacionit Dibër, në Agjencinë Rajonale të Mjedisit, Tiranë/Durrës/Dibër- klasa e pagës IV-3.*
- *Kandidati i renditur i treti me pikë, E. R. nuk zgjodhi pozicion, duke qëndruar në listë fituese për dy vite.*
- *Kandidati i renditur i katërti me pikë, E. B. nuk zgjodhi pozicion, duke qëndruar në listë fituese për dy vite.*

Në vijim të procedurës, njësia përgjegjëse (DAP) ka përcjellë aktet e emërimit, drejtuar kandidatëve dhe institucioneve të përzgjedhura prej tyre, konkretisht:

- *Me aktin nr. 4632 prot., datë 23.08.2024 të DAP, P. V. emërohet nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin Specialist në Sektorin e Administrimit të të Dhënave dhe Përpunimit të Informacionit Fier, në Agjencinë Rajonale të Mjedisit, Fier/Vlorë/Gjirokastër- klasa e pagës IV-3;*
- *Me aktin nr. 4633 prot., datë 23.08.2024 të DAP, A. Xh. emërohet nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin Specialist në Sektorin e Administrimit të të Dhënave dhe Përpunimit të Informacionit Dibër, në Agjencinë Rajonale të Mjedisit, Tiranë/Durrës/Dibër- klasa e pagës IV-3.*

Përsa i përket kandidatit P. V., nga të dhënat e administruara rezulton se P. V. ka aplikuar për procedurën e pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive në shpalljen me kod #6230-Lloji i diplomës “Arsim i Lartë”, niveli i diplomës “Bachelor”. Nga verifikimi i dosjes elektronike, referuar dokumentacionit të ngarkuar, ka rezultuar se P. V. plotëson kushtet minimale dhe kriteret e përcaktuara në shpallje dhe është kualifikuar për të vijuar me fazën e dytë të konkurrimit, sikurse është kualifikuar E. B., si dhe kandidatët e tjerë të cilët plotësonin këto kritere. Kandidati ka marrë pjesë në të gjitha fazat e konkurrimit, në përfundim të të cilës ka rezultuar fitues me pikët më të larta, sikurse sqaruam më sipër.

Referuar pretendimeve të ngritura në ankesën e E. B. lidhur me bindjet politike të P. V., sqarojmë se, në Kreun VII, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, janë përcaktuar

të drejtat e detyrimit e nëpunësit civil, e më konkretisht në nenin 37 të ligjit parashikohet detyrimi për të mos shprehur publikisht bindjet apo preferencat politike. Megjithatë, theksojmë se këto detyrime rrjedhin mbasi kandidati bëhet pjesë e shërbimit civil.

Gjithashtu, ju bëjmë me dije se, mbi vlerësimin e marrë në këtë procedurë konkurrimi si dhe mbi kandidatin P. V., E. B. ka paraqitur një ankesë të dytë pranë Departamentit të Administratës Publike, me shkresën hyrëse nr. 4677 prot., datë 28.08.2024, për të cilën DAP ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 4677/1 prot., datë 19.09.2024.

Për sa i takon pretendimit të E. B. për shkelje të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, sqarojmë se, bazuar në këtë ligj, si dhe në vendimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike””, DAP-i është organ përgjegjës ndër të tjera për administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit të dorëzuar nga funksionarët publikë, të cilët priten të emërohen në pozicione të shërbimit civil në administratën shtetërore, sikurse dy pozicionet e punës në shpalljen nr. 6230.

Plotësimi i formularit të vetëdeklarimit duhet të bëhet në mënyrë të qartë dhe pa korrigjime që vështirësojnë kuptimin e të dhënave të pasqyruara në të. Në çdo rast, plotësimi bëhet në mënyrë individuale nga personi subjekt i ligjit dhe asnjë i tretë.

Qëllimi i ligjit nr. 138/2015, të ndryshuar, është të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, të administratës publike, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to, apo largimi nga funksioni publik të personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie, ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve, sipas këtij ligji.

Ligji nr. 138/2015 i ka të përcaktuara rastet që përbëjnë pengesë për emërimin e personave në funksione publike, masat që ndërmerren në rast të ekzistencës së pengesës, si dhe pasojat që vijnë në rast konstatimi të pengesës për ushtrimin e funksionit publik.

Në rastin konkret, DAP ka ndërmarrë hapa për administrimin e formularëve të vetëdeklarimit të kandidatëve fitues të shpalljes me nr. 6230 sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 138/2015, të ndryshuar, si dhe në Kreun V të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, përpara nxjerrjes së akteve respektive të emërimit...”.

Bashkëngjitur shkresës së sipërcituar DAP, vuri në dispozicion të Komisionerit:

- Dosjen e plotë të procedurës së pranimit në shërbimin civil për shpalljen me kod 6230;
- Ankesën e E. B. të datës 26.08.2024, protokolluar në DAP me nr. 4677 prot., datë 28.08.2024, si dhe përgjigjen e DAP me shkresën nr. 4677/1 prot., datë 19.09.2024;
- Ankesën e E. B. mbi rezultatin e konkursit me kod 6230, si edhe procesverbalin e Komitetit të Përhershëm të Pranimit pas shqyrtimit të saj, përcjellë me shkresën përcjellëse nr. 4495/1 prot., datë 23.08.2024 të DAP;

- Ankesën e A. G. mbi rezultatin e konkursit me kod 6230, si edhe procesverbalin e Komitetit të Përhershëm të Pranimit pas shqyrtimit të saj, përcjell me shkresën përcjellëse nr. 4550/1 prot., datë 22.08.2024 të DAP;
- Aktin nr. 4632 prot., datë 23.08.2024 të DAP, për emërimin e P. V.;
- Aktin nr. 4633 prot., datë 23.08.2024 të DAP, për emërimin e A. Xh.

2. Në vijim përmes e-mail-it datë 08.11.2024, Komisioneri i përcolli subjektit ankues një kopje të përgjigjes së vënë në dispozicion nga ana e DAP.

Në përgjigje të e-mail-it sipërcituar, E. B. me e-mail-in datë 08.10.2024, theksoi ndër të tjera se: “...Unë e pashë me vëmendje dosjen dhe mungojnë disa dokumente.

1. *Procesverbalet e testimit me shkrim, për secilin nga kandidatët, për të parë si janë korigjuar testimet me shkrim, kodin e identifikimit, komisioni që ka korigjuar testimet me shkrim, kush janë se normalisht s’duhet të jetë i njëjti komision, nga ana logjike dhe procedurale mendoj se ka konflikt interesi se përderisa kandidatët mund të identifikohen nga karta e ID, rezulton se anëtarët kanë dijeni kë po vlerësojnë, dhe si do vlerësojnë pikët e CV dhe intervistën me gojë, si është rregullorja e brendshme për vlerësimin e kandidatëve.*
2. *Mungojnë dosja e plotë e secilit kandidat fitues, dmth CV, Librezë pune, kualifikime, pse nuk ja u kanë dhënë, si do e përcaktojmë diskriminimin nëse nuk shohim dosjen e plotë.*
3. *Mungojnë procesverbalet e intervistës me gojë për secilin kandidat, si i kanë marrë pikët, nga secili anëtar i KPP, për të parë kush nga anëtarët ka bërë më shumë favorizim.*
4. *Mungon ankesa e A. G. mbi rezultatin e konkursit e cituar në shkresën e DAP Nr. 4495/3 prot., me dt. 04.10.2024, ankesa e tij dhe kthim përgjigje nga DAP.*
5. *Vini re me vëmendje tek rezultatet e pikëve, si ka mundësi që pikët e testimit me shkrim janë të ngjashme, sa është probabiliteti të ndodhi një ngjarje e tillë, dhe si ka mundësi që tek vlerësimet me gojë kandidatët fitues kanë marrë pikë të larta në krahasim me dy vajzat e tjera.*
6. *Vini re listën e pyetjeve të intervistës së strukturuar me gojë, janë 5 pyetje teorike, të cilat unë i konfirmoj që ato na u zhvilluan, por që ishin në kundërshtim me pikën nr. 9, udhëzimi nr. 02, datë 27.03.2015, ku thuhet se: llojet e pyetjeve për intervistën me gojë duhet të zhvillohen rreth:*
 - *Pyetje lidhur me sjelljen*
 - *Pyetje lidhur me situatën (hipotetike)*
 - *Pyetje lidhur me dijet*

Nëse KPP i organizon intervistat në mënyrë të tillë, atëherë cili është ndryshimi ndërmjet testimit me shkrim dhe intervistës me gojë? Pyetje të cilën ja u kam bërë dhe s’më kanë kthyer përgjigje...Nuk më lanë të flisja për eksperiencat e punës ...është e habitshme se kam bërë shumë intervista edhe me CEO të huaj dhe s’më janë bërë pyetje rreth ligjeve në intervistë, këto bëhen në testim, ose mund të bësh 2-3 pyetje për të parë kandidatin, por jo të gjitha pyetjet vetëm teori, çfarë kuptimi ka pastaj, po ti marrim me radhë këta anëtarët e KPP dhe ti pyesim për rregulloren dhe udhëzimet e DAP thua vallë se i dinë përmendsh, kushdo që punon në institucion publik para

se të bëj një shkresë ose një procedurë, normalisht rishikon ligjin ose udhëzimin, të paktën kështu kam punuar unë, nuk e di tani metodikën e këtyre ...

Nejse unë këto vura re, ju lutem të kërkonit edhe dosjet e procedurës për lëvizje paralele për këtë shpallje sepse unë besoj se mund të evidentojmë shkelje të tjera të kryera nga KPP...”

3. Në përgjigje sa më sipër, Komisioneri me e-mail-in datë 09.10.2024, informoi ankuesen se: *“DAP ka kthyer përgjigje lidhur me kërkesat e parashtruara nga Komisioneri. Megjithatë pas konsultimit të të gjithë dokumentacionit nga ana jonë do të vendoset nëse nevojitet informacion shtesë. Sa i përket ankesës së kandidatit A. G., na është përcjell nga ana DAP, por për shkak të parashikimeve të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, nuk mund tua vëmë në dispozicion por do të vlerësohen nga Komisioneri gjatë trajtimit të çështjes.”*

4. Në vijim, E. B., përmes e-mail-it datë 09.10.2024, sqaroi ndër të tjera se: *“...doja të citoja që në shkresën nr. 1241/1, datë 18.09.2024, drejtuar DAP për informacion keni cituar në fund të shkresës pika 3 “Procesverbalet e mbajtura të konkurrimit/vlerësimit të kandidatëve gjatë testimit me shkrim dhe intervistës me gojë”, në dosjen e dokumenteve që më keni dërguar këto nuk janë por janë vetëm vendimet përfundimtare për secilin proces, jo për secilin kandidat, me një dosje të tillë që ka dërguar DAP kushdo që e sheh duket në rregull dhe nuk ka formë diskriminimi, dmth ka një procedurë të rregullt burokratike...Si do ta dalloni diskriminimin me një dosje të tillë ...?”*

Pastaj të vërtetosh që DAP është thjeshtë një vegël e partisë në pushtet kushdo qoftë ajo, është një nismë e madhe dhe varet nga personi nëse ka iniciativë, guxim dhe kërkon drejtësi për veten edhe pse në Shqipëri dihet ...si shkon drejtësia ...por të paktën njeriu i thotë vetes, do e provoj, do luftoj, do fitoj ose jo, Zoti lart e di, por të paktën do mbaj mend që luftova.

Nëse Komisioneri e vërteton ose jo rastin e diskriminimit, në fund të fundit pagën do ta marri apo jo, ndërsa unë jam e papunë për momentin dhe nuk punoj dot në sektorin privat pasi të duan në punë 56 orë në javë dhe nuk respektojnë kontratat, ndërsa sektori publik siç po e shikon me DAP ja si po funksionojnë, edhe në institucionet që funksionojnë me kontratë pune kërkon drejtori 5000 euro, të paktën kështu funksionon në Fier se Tirana ka më shumë opsione...”

5. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 1241/3 prot., datë 16.12.2024, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore. Gjithashtu, përmes kësaj shkrese Komisioneri kërkoi nga palët në proces të vihet në dispozicion të Komisionerit:

- Procesverbalet e mbajtura të konkurrimit/vlerësimit të kandidatëve gjatë procedurave të vlerësimit të dosjeve, testimit me shkrim dhe intervistës me gojë, për shpalljen e vendeve të punës për shpalljen nr. 6230.

- Kopje të CV-ve dhe dosjeve personale të kandidatëve fitues për shpalljen nr. 6230, që lidhen me: arsimin, eksperiencën në punë, kualifikimet etj.
- Si dhe informacion mbi pretendimet e ngritura nga ankuesja në e-mail-in drejtuar Komisionerit (të cilin do ta gjeni bashkëngjitur kësaj shkrese).

Seanca dëgjimore u zhvillua me datë 23.12.2024, vetëm me praninë e palës ndaj të cilës është drejtuar ankesa. Subjekti ankues nuk u paraqit në seancën dëgjimore.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Departamenti i Administratës Publike u përfaqësua⁵ në seancën dëgjimore, nga R. L. dhe A. M. Palët në seancë i qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në dhe që do të shtjellohen në vijim, gjatë arsytimit të vendimit.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesit e DAP theksuan ndër të tjera se referuar kërkesës së paraqitur nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për realizimin e procedurës së konkurrimit për dy pozicione pune në Agjencitë Rajonale Fier/Vlorë/Gjirokastrë dhe Tiranë/Durrës/Dibër, u shpallën vendet vakante për konkurrim. Pas verifikimit të dosjeve përkatëse të kandidatëve, nga ana e DAP është vijuar me procedurat e mëtejshme të konkurrimit. Në rastin konkret, sipas tyre, arsimi i kërkuar për këtë procedurë konkurrimi ka qenë vetëm arsim i lartë bachelor.

Sa i përket pretendimeve të ankueses lidhur me vendosjen e numrit personal të konkurrentëve si barkod në testimet me shkrim, u theksua se vlerësimi nga komisioni bëhet përmes sistemit kompjuterik. Teza është e gjitha me pyetje me alternativa, të cilat kandidatët pa emrin e vet, por me barkodin përkatës, përzgjedhin alternativat sipas formës që i është shpjeguar edhe në rregulloren e testimit, dhe më pas teza e testimit skanohet dhe automatikisht dalin përgjigjet nga çelësi i përgjigjeve, i cili është një çelës i unifikuar. Testimi bëhet përmes sistemit kompjuterik dhe nuk korrigjohet manualisht nga ana e komisionit përkatës.

Lidhur me pretendimin e ankueses për diskriminimin e saj për shkak të gjendjes shoqërore, përfaqësuesit e DAP sqaruan se nuk ekziston asnjë provë me anë të të cilës të provohet se ata kanë patur dijeni mbi bindjet politike të konkurrentëve fitues apo edhe vetë ankueses.

Në përfundim, sa i përket pretendimit të ankueses se komisioni i DAP gjatë intervistës me gojë ka zhvilluar sërish pyetje që lidhen me dijet dhe jo duke ju përmbajtur Udhëzimit nr. 2, datë 27.03.2015, u sqarua se komisioni është i pavaruar në hartimin e pyetjeve dhe vlerësimin e tyre, dhe DAP nuk ndërhyr në këto raste. Kandidatët i janë nënshtruar të gjithë të njëjtave pyetjeve pa asnjë lloj dallimi.

⁵ U përfaqësua me Autorizimin Nr. 4495/5 prot., datë 23.12.2024

6. Përmes shkresës⁶ nr. 4495/6 prot., datë 06.01.2025, DAP vuri në dispozicion të Komisionerit kopje të CV-ve dhe dosjeve personale të kandidatëve fitues për shpalljen me kod 6230, referuar dokumenteve të ngarkuar nga kandidatët në llogaritë e tyre personale.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm.

Bazuar në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, E. B. e datëlindjes1984 dhe është banore në qytetin e Fierit. Ajo ka përfunduar studimet e larta në degën “Administrim Biznes”, pranë Fakultetit të Tregtisë, në Universitetin e Ismail Qemali, Vlorë, në vitin 2007, duke u pajisur me Diplomë Universitare.

Ankuesja është vënë në dijeni dhe ka aplikuar më datë 26.05.2024, për të marrë pjesë në procedurën e konkurrimit për pranimin në shërbimin civil, për pozicionet vakante me kod 6230-Lloji i diplomës “Arsim i Lartë“, niveli minimal i diplomës “Bachelor”.

Në zbatim të nenit 22 dhe 25, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe të kreut II, IV dhe VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, të ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike ka shpallur procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për grupin e pozicioneve:

1. Specialist në Sektorin e Administrimit të të Dhënave dhe Përpunimit të Informacionit, Dibër, në Agjencinë Rajonale të Mjedisit, Tiranë/Durrës/Dibër - klasa IV-3;
2. Specialist në Sektorin e Administrimit të të Dhënave dhe Përpunimit të Informacionit, Fier, në Agjencinë Rajonale të Mjedisit, Fier/Vlorë/Gjirokastrë - klasa IV-3.

Në pikën 1.1 të publikimit për vendin vakant, janë shpallur kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta, si më poshtë: “

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a. Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda kategorisë IV;
- b. Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c. Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a. Të zotërojnë një diplomë të nivelit “Bachelor” në një nga fushart e Arsimit të Lartë.

⁶ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 48 prot., datë 08.01.2025

Pas përfundimit të procedurës për lëvizjen paralele, për pozicionet e cituara duke mos u shpallur asnjë kandidat fitues, DAP ka vijuar procedurat e mëtejshme të konkurrimit për pranimin në shërbimin civil.

Ligji Nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, në nenin 22, “Pranimi në shërbimin civil” përcakton ndër të tjera se: “...2. Konkurrimi organizohet në mënyrë periodike nga njësia përgjegjëse për secilin nga grupet e përcaktuara në pikën 8 të nenit 19 të këtij ligji.

3. Konkurrimi zhvillohet në këto dy faza:

a) verifikimi paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkurrimit;

b) vlerësimi i kandidatëve

4. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga komiteti i përhershëm i pranimit, i krijuar për secilin nga grupet e përcaktuara në pikën 8 të nenit 19 të këtij ligji.

5. Kandidatët fitues, që marrin mbi 70 për qind të pikëve totale të vlerësimit, renditen nga komiteti i përhershëm i pranimit, sipas pikëve të marra në listën e kandidatëve të suksesshëm (në vazhdim “lista”)...”.

Referuar nenin 22, të Ligjit Nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar, vlerësimi me pikë i kandidatëve bëhet nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP). KPP vlerëson kandidatët, realizon testimin e tyre me shkrim dhe me gojë dhe në përfundim të konkursit dorëzon pranë DAP listën e kandidatëve të renditur duke filluar nga kandidati që ka marrë më shumë pikë.

Sa më sipër, njësia përgjegjëse e DAP, ka kryer procedurën e verifikimit paraprak të dosjeve të aplikantëve, nëse ata i plotësonin kërkesat e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkurrimit. Referuar provave të administruara, rezulton se në fazën e parë, atë të verifikimit paraprak të dosjeve, janë kualifikuar për të vijuar fazën e dytë të konkurrimit 81 (tetëdhjetë e një) kandidatë.

Më pas, ankuesja dhe kandidatët e kualifikuar, janë njoftuar në rrugë elektronike nga DAP për zhvillimin e testimit me shkrim në datën 15.07.2024 dhe intervistës së strukturuar me gojë më datë 22.07.2024.

Në përfundim të fazës së testimit me shkrim, DAP ka bërë publik emrat e kandidatëve të kualifikuar, për pozicionet:

1. Specialist në Sektorin e Administrimit të të Dhënave dhe Përpunimit të Informacionit, Dibër, në Agjencinë Rajonale të Mjedisit, Tiranë/Durrës/Dibër - klasa e pagës IV-3
2. Specialist në Sektorin e Administrimit të të Dhënave dhe Përpunimit të Informacionit, Fier, në Agjencinë Rajonale të Mjedisit, Fier/Vlorë/Gjirokastrë - klasa e pagës IV-3

Sipas rendit alfabetik, kandidatët e kualifikuar ishin si më poshtë:

1. A. Xh., i cili ka marrë 52 pikë, nga 60 pikë maksimalja;
2. E. R., e cila ka marrë 56 pikë, nga 60 pikë maksimalja;
3. E. B., e cila ka marrë 52 pikë, nga 60 pikë maksimalja;
4. P. V., i cili ka marrë 56 pikë, nga 60 pikë maksimalja;

Më pas, sipas procedurave të parashikuara, është zhvilluar intervista e strukturuar me gojë për kandidatët e kualifikuar pas përfundimit të fazës së konkurrimit me shkrim. Në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë, kandidatët kanë marrë pikët si më poshtë vijon:

1. P. V., i cili ka marrë 21.6 pikë, nga 25 pikë maksimalja;
2. A. Xh., i cili ka marrë 19 pikë, nga 25 pikë maksimalja;
3. E. R., e cila ka marrë 9.2 pikë, nga 25 pikë maksimalja;
4. E. B., e cila ka marrë 9.4 pikë, nga 25 pikë maksimalja;

Referuar Vendimit datë 22.08.2024, të mbajtur nga ana e Komitetit të Përhershëm të Pranimit, rezulton se kandidatët e sipërcituar, në fazën e vlerësimit me pikë të dosjeve të dorëzuara si më poshtë vijon:

1. P. V., i cili ka marrë 10 pikë, nga 15 pikë maksimalja;
2. E. B., e cila ka marrë 10 pikë, nga 15 pikë maksimalja;
3. E. R., e cila ka marrë 7 pikë, nga 15 pikë maksimalja;
4. A. Xh., i cili ka marrë 5 pikë, nga 15 pikë maksimalja;

Në analizë të dosjes së ankuses krahasuar me P. V., për të cilin ajo ka pretenduar se është trajtuar në mënyrë të pafavorshme, rezulton se:

- Ankuesja, E. B., ka përfunduar arsimin e lartë 4 vjeçar në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, Fakulteti i Tregtisë, Dega “Administrim Biznes”. Ka një eksperiencë rreth 13 vite pune;
- P. V., ka përfunduar arsimin e lartë pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë, Dega Farmaci. Gjithashtu, ka përfunduar Master Profesional, pranë Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Dega Ekonomia dhe e Drejta në Administrimin Publik. Ka një eksperiencë rreth 15 vite pune;

Gjatë vlerësimit të dosjeve të ankuses dhe P. V., Komisioni ka mbajtur të njëjtin qendrim, pavarësisht se P. V. ka patur një eksperiencë pak më të gjatë punësimi se ankuesja.

Në përfundim të procedurave të konkurrimit, ka rezultuar se renditja e aplikantëve ka qenë si më poshtë vijon:

1. P. V. është vlerësuar me 87.6 pikë;
2. A. Xh. me 76 pikë;
3. E. R. me 72.2 pikë;
4. E. B. me 71.4 pikë.

Referuar kësaj liste, DAP në cilësinë e njësisë përgjegjëse, ka vijuar me njoftimin individual të kandidatëve për rezultatet e marra në këtë konkurs dhe me publikimin në faqen zyrtare (www.dap.gov.al) të listës së kandidatëve fitues (me mbi 70 pikë), renditur sipas rendit alfabetik. Në këtë njoftim kandidatët sqarohen edhe mbi të drejtën e ankimit, afatet, si edhe procedurën ligjore që duhet të ndjekin për të paraqitur ankesën pranë Departamentit të Administratës Publike.

Sa më sipër, nga informacioni i vënë në dispozicion nga ana e DAP, theksohet se E. B. ka depozituar në rrugë zyrtare, brenda afatit ligjor të parashikuar, ankesën e saj për vlerësimin e marrë në konkursin me kod 6230. Në përgjigje të kësaj ankese, Komiteti i Përhershëm i Pranimit, i ngritur për zhvillimin e konkursit për pranimin në nivelin ekzekutiv për grupin e pozicioneve: #6230- Lloji i diplomës “Arsim i Lartë”, niveli i diplomës “Bachelor”, është mbledhur në datën 22.08.2024 për të shqyrtuar ankesën e E. B.. Në përfundim të shqyrtimit, theksohet se KPP i ka kthyer përgjigje nëpërmjet shkresës përcjellëse të DAP me nr. 4495/1 prot., datë 23.08.2024, për të cilën ankuesja është vënë në dijeni. Nga korrespondenca e mbajtur me ankuesen, nuk rezulton që gjatë shqyrtimit të ankesës pranë Komisionerit, ajo të ketë kundërshtuar një fakt të tillë.

Në vijim, bazuar në VKM nr. 243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, pika 17, Kreu IV, i ndryshuar, njësia përgjegjëse (DAP) fton kandidatët fitues, duke respektuar renditjen e tyre, të zgjedhin nga lista e pozicioneve ekzistuese të lira, për të konkurruar. Kandidatët fitues të cilët nuk mund të përzgjedhin pozicion për shkak të renditjes së tyre me fituesit e tjerë, qëndrojnë në listë fituese për një periudhë 2 vjeçare.

Mbështetur në deklaratat e nënshkruara më datë 23.08.2024, nga kandidatët që kanë marrë më shumë se 70 pikë, rezultoi si më poshtë vijon:

- A. Xh., i renditur *i dyti*, ka zgjedhur të emërohet në pozicionin e Specialistit në Sektorin e Administrimit të të Dhënave dhe Përpunimit të Informacionit, Dibër;
- P. V., i renditur *i pari*, ka zgjedhur të emërohet në pozicionin e Specialistit në Sektorin e Administrimit të të Dhënave dhe Përpunimit të Informacionit, Fier;
- Ankuesja, E. B., e renditur *e katërta*, nuk ka zgjedhur pozicionet e mësipërme, duke qendruar në listë pritje për dy vite;
- E. R., e renditur *e treta*, nuk ka zgjedhur pozicionet e mësipërme, duke qendruar në listë pritje për dy vite.

Sa më sipër, nga informacioni i administruar rezulton se ankuesja ka depozituar në rrugë zyrtare, brenda afatit ligjor të parashikuar, ankesën e saj datë 26.08.2024, për vlerësimin e marrë në konkursin me kod 6230. Në përmbajtje të saj, ankuesja ka depozituar të njëjtat parashtrime për diskriminim të depozituara edhe tek Komisioneri. Në përfundim të shqyrtimit, DAP i ka kthyer përgjigje pretendimeve për diskriminim, nëpërmjet shkresës nr. 4677/1 prot., datë 19.09.2024, për të cilën E. B. është vënë në dijeni.

Nga provat e administruara, rezulton se P. V., ka aplikuar për procedurën e pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive në shpalljen me kod #6230- Lloji i diplomës “Arsim i Lartë”, niveli i diplomës “Bachelor”. Nga verifikimi i dosjes elektronike të përcjellë nga DAP, referuar dokumentacionit të ngarkuar, ka rezultuar se P. V. ka plotësuar kushtet minimale dhe kriteret e përcaktuara në shpallje dhe është kualifikuar për të vijuar me fazën e dytë të konkurrimit, sikurse është kualifikuar edhe ankuesja, E. B., si dhe kandidatët e tjerë të cilët plotësonin këto kritere. P. V. ka marrë pjesë në të gjitha fazat e konkurrimit, në përfundim të të cilave ka rezultuar fitues me pikët më të larta.

Sa i përket pretendimeve të ankueses lidhur me bindjet politike të P. V., Komisioneri analizon parashikimet e ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar. Kreu VII, i tij, përcakton të drejtat e detyrimit e nëpunësit civil. Në nenin 37 të ligjit parashikohet detyrimi për të mos shprehur publikisht bindjet apo preferencat politike, ku citohet se: “1. Nëpunësi civil ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike jashtë orarit zyrtar. Nëpunësi civil nuk duhet të shprehë publikisht bindjet apo preferencat e tij politike.

2. Nëpunësit civilë të nivelit të lartë drejtues nuk mund të jenë anëtarë të partive politike. Nëpunësit civilë të kategorive të tjera kanë të drejtë të jenë anëtarë të partive politike, por nuk mund të jenë anëtarë të organeve drejtuese të tyre.

3. Nëpunësi civil ka të drejtën të kandidojë dhe të zgjidhet në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë apo për organet e qeverisjes vendore. Në këtë rast, nëpunësi detyrohet të kërkojë pezullimin nga detyra.”

Mbështetur edhe në interpretimin e DAP, por edhe në përcaktimet e cituara në ligjin 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar, detyrimin për të mos shprehur bindjet apo preferencat politike, rrjedhin pasi kandidati bëhet pjesë e shërbimit civil. Pra, në këtë kuptim, pavarësisht faktit që sipas provave të administruara, P. V. ka bërë publike bindjet apo preferencat e tij politike, nuk ka asnjë ndalim ligjor, i cili nuk lejon konkurimin apo emërimin e tij në pozicione që bëjnë pjesë në shërbimin civil. Ndalimi për të mos shprehur bindjet apo preferencat e tij politike, lidhet me momentin pas emërimit në pozicionet që janë pjesë e shërbimit civil.

Për sa i takon pretendimit të ankueses drejtuar KPP-së, për procedurën e intervistës së strukturuar me gojë, Komisioneri do të analizojë parashikimet e Udhëzimit Nr. 02, datë 27.03.2015 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes së detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

Ndër të tjera, udhëzimi në ndarjen IV/2 “Funksionet e Komitetit të Pranimit për Lëvizjen Paralele dhe Vlerësimi i Kandidatëve (Vlerësimi i Dokumentacionit dhe Intervista e Strukturuar me Gojë)” përcakton se: “...5. Pikët për çdo element (përvojë, trajnim apo kualifikim dhe certifikim/vlerësim) mbliidhen. Pikët në total mbliidhen dhe pjesëtohen me 3, duke i rrumbullakosur deri në një presje dhjetore.

6. *Modeli i vlerësimit të dokumenteve të kandidatëve për Komisionin e Brendshëm është dhënë në Aneksin nr. 1.*

7. *Komisioni i Brendshëm harton për intervistën me gojë një sërë pyetjesh, të cilat janë të njëjta për të gjithë kandidatët. Kur DAP të krijojë bankën e pyetjeve, Komisioni i Brendshëm do t'i zgjedhë pyetjet për intervistën me gojë nga kjo bankë dhe mund t'i përshtasë ato.*

8. *Përmbajtja e pyetjeve të intervistës me gojë lidhet me njohuritë, aftësitë, kompetencat që nevojiten për pozicionin e punës, eksperiencën, motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e karrierës.*

9. *Llojet e pyetjeve për intervistën me gojë:*

- ✓ *Pyetje lidhur me sjelljen;*
- ✓ *Pyetje lidhur me situatën (hipotetike);*
- ✓ *Pyetje lidhur me dijet... ”.*

Nga informacioni i vënë në dispozicion nga palët në proces, rezulton se të gjithë kandidatët që janë bërë pjesë e procedurës së intervistës me gojë, i janë nënshtruar të njëjtave pyetje me ankuesen. Referuar analizës së bërë Udhëzimit sipërcituar, sa i përket procedurës së intervistës me gojë, rezulton që Komiteti i Pranimi është organi i cili përzgjedh fondin e pyetjeve për aplikantët që i nënshtrohen kësaj procedure. Sakaq, pavarësisht faktit që në udhëzimin e sipërcituar përcaktohen llojet e pyetjeve për intervistën me gojë, nuk rezulton asnjë ndalim që ai të përzgjedh vetëm pyetje lidhur me dijet apo vetëm lidhur me sjelljen.

Nga analiza e sipërcituar, Komisioneri vlerëson se:

- Departamenti i Administratës Publike, ka zhvilluar procedurat e konkurrimit për shpalljen me kod 6230, mbështetur në parashikimet e legjislacionit të shërbimit civil;
- Nuk ka asnjë ndalim ligjor, i cili nuk lejon konkurrimin apo emërimin e P. V. në pozicione që bëjnë pjesë në shërbimin civil apo personave që ndodhen në të njëjtat kushte me të;
- Referuar vlerësimit të dosjeve të ankueses dhe P. V., Komisioni ka mbajtur të njëjtin qendrim, pavarësisht se P. V. ka patur një eksperiencë pak më të gjatë punësimi se ankuesja, me dy vite;
- Nuk rezulton të ketë asnjë ndalim që KPP të përzgjedh vetëm pyetje lidhur me dijet, si në procedurën e konkurrimit ku ka marrë pjesë ankuesja.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”

Në nenin 12/1/b) të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në

nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve;... ”.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimi e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Në përfundim, Komisioneri gjykon se Departamenti i Administratës Publike, nuk ka ndërmarrë veprime që e kanë ekspozuar subjektin ankues ndaj një trajtimi të pabarabartë apo disfavorizues. Nga analiza e provave të vëna në dispozicion nga palët, Komisioneri vlerëson se nuk kemi një trajtim të pabarabartë apo të pafavorshëm të subjektit ankues.

Në mungesë të një trajtimi të pabarabartë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Departamentit të Administratës Publike, për shkaqet e pretenduara nga ankuesja.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, të ankueses E. B., nga ana e Departamentit të Administratës Publike, për shkaqet e pretenduara prej saj.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Gjendja shoqërore dhe çdo shkak tjetër)
(Fusha: Punësim)